

Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga NLB Skladi – Lubjanë, Slloveni mbi Solverv, termocentralet diellore d.o.o., Lubjanë, Slloveni, Zelena struja d.o.o., Zagreb, Kroaci, dhe RES SPV CZ s.r.o., Pragë, Republika Çeke dhe marrjen e projekteve energjetike

(lënda nr. 08-162/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 18.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga ana e NLB Skladi – Zeleni prehod I A, shoqëri e dedikuar për investime, sh.p.k. (namenska družba za naložbe, d.o.o.), Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni mbi Solverv, termocentralet diellore d.o.o., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni, Zelena struja d.o.o. për prodhimin e energjisë elektrike, Barutanski breg 27, 10000 Zagreb, Kroaci, dhe RES SPV CZ s.r.o., Plinarni 1617/10, Holeshovice, 170 00 Pragë, Republika Çeke, si dhe marrjen e të gjitha apo disa prej projekteve energjetike të mëposhtme:

1.Projekti PV Hoçe, në pronësi dhe aktualisht i zhvilluar nga Solverv, termocentralet diellore d.o.o., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni;

2.Projekti PLU, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga RESALTA SHOQËRI PËR MENAXHIMIN E SHËRBIMEVE ENERGETIKE sh.p.k., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni;

3.Projekti Juteks HP, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga RESALTA SHOQËRI PËR MENAXHIMIN E SHËRBIMEVE ENERGETIKE sh.p.k., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni;

4.Projekti GH Primus, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga RES ERP, shoqëri për menaxhimin e shërbimeve energjetike sh.p.k., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni;

5.Projekti PV Juteks, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga RES ERP, shoqëri për menaxhimin e shërbimeve energjetike sh.p.k., Amerishka ulica 8, 1000 Lubjanë, Slloveni;

6.Projekti OTK, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga Resalta Çeh Ripablik s.r.o., Plinarni 1617/10, Holeshovice, 170 00 Pragë 7, Republika Çeke; dhe

7.Projekti Rovinj, në pronësi dhe aktualisht duke u zhvilluar nga Zelena Struja sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike, Barutanski breg 27, 10000 Zagreb, Kroaci.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Veprimtaria e regjistruar e Parashtruesit është aktivitete të kompanive holding.

Parashtruesi është pjesë e Grupit NLB.

Grupi NLB në Maqedoninë e Veriut aktualisht ka 3 shoqëri të lidhura:

- NLB Banka SHA Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me NUAS 4664531, me veprimtari prioritare – ndërmjetësim tjetër monetar;
- Shoqëria për lizing NLB LEASE&GO SHPK Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup me NUAS 7628838, me veprimtari prioritare lizing financiar; dhe
- Shoqëria për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese NLB Fonde SHA Shkup me seli në bul. Partizanski Odredi nr. 14A-1/2 Shkup me NUAS 6364578, me veprimtari prioritare: veprimtari të menaxhimit me fonde.

Shitësit dhe përkatësisht Shoqëritë e Synuara, janë shoqëri për shërbime energjetike (ESCO), aktive në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore, veçanërisht në Slloveni, Kroaci, Çeki dhe Serbi, ku janë zhvillues kryesorë të projekteve të ndryshme për efikasitet energjetike dhe energji të rinovueshme.

Shoqëritë e Synuara, para Transaksionit, janë pjesë e Grupit RESALTA.

Shoqëritë e Synuara nuk kanë subjekte të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe as nuk kanë realizuar qarkullim në vitin 2024 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, përqendrimi i propozuar ka të bëjë me tregun e: prodhimit të energjisë elektrike/zgjidhjeve energjetike në Slloveni, Kroaci dhe Republikën Çeke.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Shkup

24.11.2025